

KONTRATE DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(Lloji kuote kapitali)

Sot me date 29/02/2024 ne palet e meposhtme redaktojme kete kontrate dhurimi si me poshte vijon:

PALA DHURUESE:

1. Edmond Haxhinasto, atësia Llazar, amësia Lizabeta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Zef Jubani; Nd. 8; H. 1; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/11/1966, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035677669 dhe nr. personal G61116022M, (më poshtë i quajtur "Dhuruesi")



PALA PRANUESE E DHURIMIT:

Enkeleida Haxhinasto, atësia Kozma, amësia Zhaneta, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë adresë Zef Jubani; Nd. 8; H. 1; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 13/01/1972, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035677680 dhe nr. personal H25113039T (më poshtë i quajtur "pranuese e dhurimit"),

Dhuruesi dhe Perfituesi i dhurimit, referuar të dy së bashku do të quhen "Palët".

Të përgjithshme

1. Dhuruesi është zotërues i 1 kuote, qe perben **50(pesedhjete)** % te kapitalit të Shoqërisë "EHN Group" shpk, me seli ne Tirane Tirane Njesia administrative nr.5, Rruga "Zef Jubani", Ndertesa nr.8, Hyrja nr.1, Apartamenti nr.23, Tirane.
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS** M41413001L me objekt "Sherbim konsulence te specializuar financiare dhe strategjike të shitjeve dhe blerjeve të kompanive (Mergers & Acquisitions); ngritje të fondeve (fundraise); studime tregu;projekte zhvillimi per kompani brenda dhe jashte vendit;konsulence manaxhimi të përgjithshëm dhe strategjike qeperfshin fushat e institucioneve, politikës dhe politikave, teekonomise dhe tregut te lire, te te drejtave te individeve, te grupeve të interesit dhe organizatave; konsulence per blerje dhe shite të pasurive të paluajtshme; konsulence për menaxhim te riskut; konsulence për menaxhim portofoli si pjese e strategise së investimeve dhe shperndarjes së aseteve; investime te kapitalit të bashkuar në letra me vlere financiare; menaxhim, shitje dhe marketing te produkteve te investimit per klientet; investime ne kompani private dhe publike; sherbime turistike, guida turistike, transport turistik,shërbime turistike te detit, malor, kulturor, shendetësor, organizim i grupeve turistike brenda dhe jashte vendit; shitblerje pronash; katering; menaxhimi i qirave afatshkurter dhe afatmesëm të bujtinave luksoze, B&B-ve dhe apartamenteve."
3. Kapitali i shoqërisë është 100 000 lek.
4. Shoqëria zotërohet nga dy ortake:



- a. Z. Edmond Haxhinasto i cili zoteron 1 kuote qe perben 50% te kapitalit themeltar
- b. Zj. Eliza Naço, e cila zotëron 1 kuote qe perben 50% te kapitalit themeltar

Neni 1 **Objekti**

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Dhuruesi i kalon pranueses se dhurimit ½ e kutotes qe zoteron pra 25 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri pa asnje kundershperblim si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.

Pranuesja e Dhurimit, pranon dhurimin dhe kalimin e pronesise se pa asnje kundershperblim duke qene mirnjohese ndaj dhuruesit.

Neni 2 **Kalimi i pronësisë mbi kuotat**

Kalimi i pronësisë nga Dhuruesi te pranuesja e Dhurimit do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

Neni 3 **Garancitë**

Dhuruesi në lidhje me kapitalin që zotëron, garanton se :



1. Është pronar i vetem i kapitalit të dhuruar. Në rast të kundërt pala dhuruese merr përsipër personalisht zgjidhjen e çdo lloj konflikti.
2. Në të njëjtën kohë, pala dhuruese merr përsipër dhe siguron palën pranuese te dhurimit se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kapitali objekt dhurimi:
 - Është te lira nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
 - Nuk është objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
 - është i lirë nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;
 - Nuk është objekt i pretendimeve nga asnjë zyrë përmbarimi, shtetërore dhe/ose private.

Neni 4 **Ligji i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 5 **Regjistrimi**

- Kjo kontratë duhet të regjistrohet pranë QKB-së në bazë të ligjit **Ligj Nr. 131-2015 Për Qendrën Kombëtare Të Biznesit** i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit ka efekt deklarativ.
- Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria "EHN Group" Sh.p.k do të ketë 3 ortakë:
Z. Edmond Haxhinasto zotërues i 25% të kapitalit
Zj. Enkeleida Haxhinasto, zotëruese 25% të kapitalit
Zj. Eliza Naço , zotëruese e 50 % të kapitalit



- Dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga çasti i kalimit deri në çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

Neni 6

Interpretimi i Kontratës

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 7

Njoftimi zyrtar midis palëve

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim ndërmje palëve do të bëhet në formë të shkruar dhe në adresat e përshkruara në këtë kontratë.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi apo zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, do të zgjidhet me bisedim dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jete *Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë*.

Neni 9

Hartimi i Kontratës


Kjo kontratë hartohet në kater njësi origjinale të cilat kanë të njëjtën përmbajtje dhe vlerë ligjore, prej të cilave nga 3 njësi i mbajnë palët dhe një njësi depozitohet pranë QKB-së nepermjet sistemit e-albania.


Ne Palët deklarojme se kuptojme dhe se e pranojmë këtë kontratë, pasi ajo është në përputhje me vullnetin tone të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajmë atë rregullisht.

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESI

PRANUESJA E DHURIMIT


Adnan Pralaj


Eubekinda Hashumasto